



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 220/2 Prot.

Tiranë, më 10/02 /2014

Lënda: Dërgohet rekomandim për zgjidhjen e situatës emergjente të mungesës së medikamenteve pranë IEVP Peqin.

Drejtuar: **Z. Artur ZOTO**
Drejtor i Përgjithshëm
Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve

Tiranë

I nderuar Z. Zoto,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përmbushje të qëllimit të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin si dhe bazuar në kompetencën që i jepet në bazë të nenit 32, pika 1, shkronja “F”, të këtij ligji, për të bërë rekomandime për çfarëdo lloj çështje që lidhet me diskriminimin, parashtron sa më poshtë vijon:

Mbështetur në Urdhrin nr. 29, datë 06.02.2014 “Për kryerjen e inspektimit pranë IEVP Peqin” të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në datën 06.02.2014, u krye inspektim pranë IEVP Peqin, si pasojë e njoftimit telefonik, që një i dënuar bëri pranë Zyrës së KMD-së.

Sipas informacionit të marrë nga i dënuari Bledar Fagu, pranë IEVP Peqin mungon insulina për të dënuarit që vuajnë me diabet. Që nga data 01.02.2014, pranë kësaj IEVP-je mungon sasia e insulinës së administruar nga të dënuarit diabetikë për vaktin e darkës. Ky fakt u konstatua edhe nga inspektorët e Komisionerit, të cilët patën kontakt të drejtpërdrejtë me të dënuarit Bledar dhe Luan Fagu, të dy të sëmurë diabetikë prej disa vitesh.

Z. Armand Shqarri, Drejtor i IEVP-së Peqin dhe Z. Fabian Hoxha, Përgjegjës i Sektorit Shëndetësor informuan inspektorët e Komisionerit se gjendja në fjalë ishte krijuar si pasojë e ndërprerjes së kontratës 3-palëshe për furnizimin me medikamente mjekësore të IEVP-ve. Me

shkresën nr, 187, datë 16.01.2014, Drejtuesi i I EVP Peqin është vënë në dijeni të faktit se, ISKSH ka ndërprerë përfshirjen në skemën e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, personat të cilët vuajnë dënimin në I EVP Peqin, duke i lënë këta të sëmurë pa medikamente. Lidhur me emergjencën mbi mungesën në medikamente, Drejtori i I EVP-së dhe Përgjegjësi i Sektorit Shëndetësor kanë bërë me dije, nëpërmjet disa shkresave, edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, ku kanë kërkuar zgjidhje sa më të shpejtë të këtij problemi, pasi kjo situatë rëndon seriozisht gjendjen në I EVP.

Në datën 07.02.2014, pas komunikimit telefonik me Z. Armand Shqarri, Drejtor i I EVP-së Peqin, informohemi se është siguruar sasia e insulinës për të sëmurët diabetikë për një periudhë 10 ditore.

Për sa më sipër, nisur nga situata e konstatuar, si dhe bazuar në kompetencat që neni 32 pika 1/“f” i ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” i jep institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, por edhe në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 7571/2, datë 31.12.2012, që ekziston midis dy institucioneve tona:

REKOMANDOJMË:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në frymën e respektimit të ligjit dhe të drejtave e interesave të ligjshme të qytetarëve, bazuar në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, të vlerësojë në mënyrë maksimale problemin e ngritur, duke i dhënë zgjidhje sa më të shpejtë, furnizimit me mendikamente mjekësore të I EVP Peqin, duke patur parasysh gjendjen emergjente të krijuar pranë kësaj I EVP-je, ku vuajnë dënimin, ndërmjet të sëmurëve diabetikë, edhe shumë të sëmurë të tjerë kronikë, me patologji të ndryshme.
2. Të njoftohet Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbi masat e marra për zgjidhjen e kësaj situatë emergjente, si dhe mbi mënyrën se si do të procedohet më tej lidhur me sigurimin e medikamenteve të nevojshme të dënuarve pranë kësaj I EVP-je.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

